



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1027/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Afijete Sada Gllongjani kryesuese, Zyhdi Haziri dhe Kymete Kicaj anëtar, duke vendosur përkritazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovës Lazër Nrejaj nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.1027/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovës Lazër Nrejaj nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë me të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave vendvotimet 0211C/01R dhe 0225C/03R në Komunën e Gjakovës.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovës Lazër Nrejaj nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë me të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave vendvotimet 0211C/01R dhe 0225C/03R, për shkak se në këto vendvotime i mungojnë votat të cilat i janë bartur kandidatëve tjerë nga i njëjti subjekt.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovës Lazër Nrejaj nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë ka paraqitur apel me të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave vendvotimet 0211C/01R dhe 0225C/03R në Komunën e Gjakovës.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij nuk ka ofruar dëshmi te qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin

konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.1027/2021 më datën 07.11.2021



**Kryesuesja e Panelit
Afijete Sada Gillogjani**

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.